



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), nenit neni 5 paragrafi 1.2. nënparagrafi 1.2.3 , nenit 17 paragrafi 1, 7 dhe 9, dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, datës 31.07.2013, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.41, 02/05 për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues urban, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja b), nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b) dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d), të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Kuvendi Komunal në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.12.2016, merr këtë:

VENDIM

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR TËRSINË URBANE "B" TË "LAGJËS PRISHTINA E RE-ZONA LINDJE"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për tërsinë urbane "B" të "lagjës Prishtina e Re- Zona Lindje".

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm nga neni 1 i këtij Vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me

nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4

Kufiri i territorit

Me Planin Rregullues të Hollësishëm nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e përfshirë në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës, dhe parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonës Kadastrale Matëçan dhe Zonës Kadastrale Hajvali , e cila ka një sipërfaqe prej $S = 109$ Ha.

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 60 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projekt propozimi i Planit Rregullues të Hollësishëm para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e propozim Planit Rregullues të Hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 10

Gjuha Zyrtare

Plani Rregullues i Hollësishëm sipas nenit 1 të këtij Vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.nr. 035-295953, më 06.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT

Halim Halimi, jur. i dipl.

ARSYETIM

i Vendimit për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë urbane "B" të - "Lagjës Prishtina e Re-Zona Lindje"

Komuna e Prishtinës është në proces të mbledhjes së të dhënave për hartimin e Hartës Zonale. Një pjesë e konsiderueshme e incizimeve gjeodezike për Komunë janë përfunduar dhe një pjesë e tyre është në proces të tenderimit për fillimin incizimeve për zonat e mbetura. Si rrjedhojë, deri në përfundimin e këtyre incizimeve dhe futjen e të gjitha të dhënave në sistemin GIS, që kanë të bëjnë me gjendjen faktike-ekzistuese dhe atë të planifikuar me plane të niveleve të ndryshme në Komunën e Prishtinës, është i pamundur fillimi i hartimit të Hartës Zonale të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, dhe duke u bazuar në kërkesat e pronarëve të tokave (sipas kufirit të propozuar për trajtim) marrëveshjeve të arritura mes pronarve dhe investitorëve dhe duke e parë edhe interesin e Komunës së Prishtinës për realizimin e Planeve Rrehulluese Urbane ekzistuese, Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme fillimin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për një pjesë të - "Lagjës Prishtina e Re - Zona Lindje" i cili plan do të inkorporohet më pastaj në Hartën Zonale të Komunës së Prishtinës.

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është zonë e përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal i miratuar nga Kuvendi Komunal me nr.01-031-156871, dt. 27.08.2013 dhe me Plan Zhvillimor Urban i miratuar nga Kuvendi Komunal me nr. nr.01-035-181427, dt.24.09.2013. Poashtu, kjo zonë gjendet brenda Planit Rregullues " Prishtina e Re-Zona Lindje" i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës me 01.nr.035-186833 dt. 02.10.2013.

Pasi që Plani Rregullues aktual dhe Plani Zhvillimor Urban kanë mos përputhje të madhe jo vetëm në strukturën urbane mirpo edhe në infrastrukturen e planifikuar rrugore, gjegjësisht banimi individual sipas Planit Rregullues aktual është i shtrirë në zonën e prroit me qëllim implementimi i këtij plani është i pamundur, poashtu infrastruktura rrugore e planifikuar nuk është e bazuar në gjendjen faktike të terrenit ku sipas kësaj realizimi i kësaj infrastrukture paraqet një sfidë të madhe për Komunën e Prishtinës.

Poashtu me Planin Zhvillimor Komunal përgjatë prroit është planifikuar "Kanali i ujit dhe propozimi rrjetit ekologjik" me një profil të këtij kanali deri 150m, e që sipas Planit Rregullues " Prishtina e Re-Zona Lindje" në këtë zonë është propozuar ndërtim individual.

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm përfshinë një sipërfaqe prej S= 109 Ha.

Plani Rregullues i Hollësishëm do të përcaktojë kushtet ndërtimore sipas ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues me nr.41, 02/05.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm duke u bazuar në Neni 11, pika 1.6.1 të Ligjit Nr. 04/L-174 përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore të veta do të emëroj një ekip profesional i cili do ta hartoj Planin Rregullues të Hollësishmëm duke e inkuadruar me modifikimet e duhura edhe propozimin e zonës për trajtim.

Para finalizimit të Projektplanit Rregullues të Hollësishëm, Komuna do ta vë draftin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim dhe kjo periudhë do të zgjas 30 dite.


Pas shqyrtimit publik , Komuna do ti shqyrtoj , analizoj dhe inkorporoj propozimet qe kanë derivuar nga debati publik dhe do ta dorëzoj Projektplanin rregullues Të Hollësishëm në Kuvend Komunal për aprovim përfundimtar.

Ky plan do të mbuloj një periudhë së paku 8 vjecare dhe ndryshimi i tij do të bëhet sipas ligjit në fuqi.

Duke pasur parasyesh që udhëzim administrativ për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, është në prag të nënshkrimit nga Ministria përkatëse, ku pas nënshkrimit të këtij udhezimi do të inkorporohen dispozitat gjatë hartimit të Planin Rregullues të Hollësishëm.

Bashkangjitur gjeni ekstraktet nga PZHK, PZHU dhe PRRU për zonën e trajtuar.

EKSTRAKTI NGA “PRRU”



EKSTRAKTI NGA “PZHU”



EKSTRAKTI NGA “PZHK”

